

Policia shton kontrollet në Lezhë pas vrasjes së policit, arrestohet 52-vjeçarja duke kultivuar kanabis, në kërkim bashkëshorti dhe djali

Publikuar: 2021-09-30 10:06 am



Policia e Lezhës ka zhvilluar kontrolle të shtuara në të gjithë qarkun, për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve dhe të armëmbajtjes pa leje. Gjatë aksionit, policia ka goditur një rast të armëmbajtjes pa leje në Kurbin, duke arrestuar poseduesin, si dhe ka goditur një rast të kultivimit të bimëve narkotike në Lezhë, duke vënë në pranga një shtetase, si dhe duke shpallur në kërkim bashkëshortin dhe djalin e saj. Gjithashtu, blutë e Lezhës kanë sekuestruar një armë zjarri pistoletë, municion luftarak dhe një automjet.

Njoftimi i policisë:

Shërbimet e Policisë Kurbin, në vijim të punës për evidentimin dhe goditjen e paligjshmërisë në fushën e armëmbajtjes pa leje, me qëllim rritjen e parametrave të sigurisë, bazuar dhe në informacionet e marra në rrugë operative, për një shtetas që qarkullonte me armë zjarri në automjet, në vendin e quajtur " Ura e Milotit", kanë lokalizuar dhe ndaluar mjetin e dyshuar.

Gjatë kontrollit të ushtruar në automjetin tip "Peugeot", me drejtues shtetasin R. Ll., është gjetur një armë zjarri pistoletë, më krehër me fishekë, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, së bashku me automjetin.Në përfundim të veprimeve, nga specialistët për Hetimin e Krimin në Komisariatin e Policisë Kurbin u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit R. Ll., 22 vjeç, banues në Mamurras, për veprën penale "Mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyes dhe municionit".

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Lezhë, në vijim të punës së pandërprerë për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e veprimtarisë së paligjshme të kultivimit të bimëve narkotike, pas informacioneve të marra në rrugë operative se në fshatin Gocaj, Një Administrative Balldre, po kultivoheshin bimë narkotike, kanë bërë arrestimin në flagrancë të shtetases:

A. C., 52 vjeçe, banuese në Gocaj, Lezhë. Gjithashtu, janë shpallur në kërkim shtetasit F. C., 55 vjeç dhe A. C., 22 vjeç, bashkëshorti dhe djali i shtetases A. C. Shtetasja A. C. është kapur në kushtet e flagrancës, duke kultivuar bimë narkotike në tokën në pronësi të tyre, në fshatin Gocaj, Lezhë. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe Kurbin, veprime të mëtejshme.

/BW

Related



Drogë, kallashnikov dhe municion luftarak, arrestohet 26-vjeçari në Mirditë
Në "Kronike"



Kultivonin bimë narkotike në pyll, në pranga babai, shpallet në kërkim i biri. Arrestohet edhe kryeplaku
Në "Fokus"



Iu gjet në servis pistoletë me fishekë, shpallet në kërkim pronari 31-vjeçar në Lezhë, procedohet penalisht punonjësi
Në "Kronike"

Kategoria: Kronike, Te Gjitha



Policia shton kontrollet në Lezhë pas vrasjes së policit, arrestohet 52-vjeçarja duke kultivuar kanabis, në kërkim bashkëshorti dhe djali

Policia e Lezhës ka zhvilluar kontrolle të shtuara në të gjithë qarkun, për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën ...



Analiza e DW/ "Serbia mes Rusisë dhe Perëndimit, mburrja boshe e Vuçiç për krizën në veri të Kosovës, shteti i vetëm që mund të sjellë rregull"

Kriza në veri të Kosovës ka shkaktuar reagime të shumta në Beograd. Vizita e ambasadorit rus tek njësitë ushtarake ...



Ylli i Saimir Hoxhës vendoset në memorialin e dëshmorëve të Policisë, Rama flet mes shiut: Fëmijët e tij nuk do të jenë vetëm

Ylli i nënkomisarit Saimir Hoxha është vendosur në memorialin para Ministrisë së Brendshme bashkë me mbi 200 dëshmorë të tjerë ...



Ndërron jetë tek Infektiv një grua shtatzënë, ndodhej në reanimacion prej dy ditësh

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur sot në Spitalin Infektiv, ku raportohet se ka ndërruar jetë nga koronavirusi një grua ...



Rikthehen reshjet në territor dhe ulen temperaturat, ky është parashikimi i motit për sot

Vendi ynë sot do të mbizotërohet nga alternime kthjellimesh dhe vranësirash duke sjellë mot me reshje në të gjithë vendin. ...

Analiza e DW/ "Serbia mes Rusisë dhe Perëndimit, mburrja boshe e Vuçiç për krizën në veri të Kosovës, shteti i vetëm që mund të sjellë rregull"

Kriza në veri të Kosovës ka shkaktuar reagime të shumta në Beograd. Vizita e ambasadorit rus tek njësitë ushtarake ...

Rikthehen reshjet në territor dhe ulen temperaturat, ky është parashikimi i motit për sot

Vendi ynë sot do të mbizotërohet nga alternime kthjellimesh dhe vranësirash duke sjellë mot me reshje në të gjithë vendin. ...

Ylli i Saimir Hoxhës vendoset në memorialin e dëshmorëve të Policisë, Rama flet mes shiut: Fëmijët e tij nuk do të jenë vetëm

Ylli i nënkomisarit Saimir Hoxha është vendosur në memorialin para Ministrisë së Brendshme bashkë me mbi 200 dëshmorë të tjerë ...

Pse duhet t'i hiqni këpucët sapo të ktheheni në shtëpi? Ja pasojat që do të kenë në shëndetin tuaj nëse nuk veproni kështu

Por përveç mikrobeve dhe baktereve, ka edhe disa arsye të tjera për të mos i mbajtur këpucët në shtëpi, shkruan ...

Ndërron jetë tek Infektiv një grua shtatzënë, ndodhej në reanimacion prej dy ditësh

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur sot në Spitalin Infektiv, ku raportohet se ka ndërruar jetë nga koronavirusi një grua ...

"Vrasja mund të ishte evituar", eksperti thirrje policëve: Mbroni veten pastaj ne!

Profesor i kriminalistikës, Ervin Karamuço i ftuar mbrëmjen e sotme në emisionin Open në Top Channel tha se vrasja e nënkomisarit ...

hapur.portal@gmail.com

Kontaktet

Për reklama, spote publicitare, banere, shkrime promocionale, na kontaktoni në këtë adresë emaili:
hapur.portal@gmail.com

Për të raportuar mbi ngjarje të ndryshme ose për të bërë denoncime, na kontaktoni në këtë nr
Cel/watsapp: 0696205874

Na pelqe në facebook: **Eni Vasili - Open**
Na ndiq në instagram: **@hapur.al**

NIPT: L81714018A